



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.18, datë 08.03.2023

**PËR**  
**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË**  
**TERRITORIT NR.15, DATË 02.02.2018 DHE DELEGIMIN E KOMPETENCAVE**

Në mbështetje të neneve 28, 29 dhe 113, të Kodit të Procedurave Administrative; neneve 7, shkronja “ç”, 14/1, pika 2, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjekteve zhvilluese shoqërive “Geci”sh.p.k dhe “Aner”sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë ndryshimin e Vendimit të KKT-së Nr.15 datë 02.02.2018 “Për miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Zgjerim i kapaciteteve akomoduese e shërbimeve të Hotel Tirana International me shtesë anësore dhe kullë me destinacion Hotel me 5 yje dhe qendër shërbimesh turistike, Bashkia Tiranë, me subjekte zhvilluese shoqëritë “Geci”sh.p.k dhe “Aner”sh.p.k.”
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë, të miratuara me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit, për objektin e përmendur në pikën 1, zëvendësohen me dokumentet bashkëlidhur këtij Vendimi.
3. Procedurat administrative/ligjore për miratimin e ndryshimeve në projekt gjatë ndërtimit apo/dhe të shtyrjes së afatit, për objektin e përmendur në pikën 1, të këtij Vendimi, do të vijohen nga Bashkia Tiranë, sipas përcaktimeve dhe rregullave të parashikuara në dispozitat e Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në përputhje me Marrëveshjen përkatëse “Për Delegimin e Kompetencave” të nënshkruar mes Kryetarit të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Kryetarit të Bashkisë Tiranë, bashkëlidhur këtij Vendimi.



4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

**KRYETARI**



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË


BELINDA BALLUKU



SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 27 / 12 / 2023